

Procesverbal - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: **“Blerje veshje të ndryshme pune për UKT sh.a”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Veshje pune të veçanta

Vlera e fondit limit: : 4,948,500 (kater milion e nenteqind e dyzet e tete mije e peseqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht në vlerën 98.970 (nentedhjet e tete mije e nenteqind e shtatedhjet)leke*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$4.948.500 \times 30\% = 1.484.550$$

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 2(dy) viteve të fundit, (2020, 2021) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e 2020,2021, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht 989.700 (nenteqind e tetëdhjetë e nente mije e shtatëqind) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$4.948.500 \times 20\% = 989.700 \text{ lekë}$$

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.5. Oferta teknike:

Skeda teknike të tekstilit të përdorur për prodhimin e artikujve, e lëshuar nga prodhuesi i tekstilit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

2.6.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

2.7.Operatori ekonomik ofertues, në ditën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Prokurimeve, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a , me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027 Tiranë, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara nga një mostër për secilin nga zërat e mallrave objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmërinë e specifikimeve të kërkuara.

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurave.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 6 gërma a), gërma c) e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterëve të sipërcituara ka për qëllim verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë të interesuar me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi me sukses.

2.8.Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX për tekstilet të vlefshme.

2.9.Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikujt për këtë objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, emrin, funksionin e zyrtarit nënshkruar, vulën e shoqërisë (kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi), të jetë i lëshuar për këtë objekt prokurimi dhe për llogari të Autoriteti Kontraktor UKT sh.a.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbi certifikatën OEKO-Tex është përcaktuar bazuar në nenin 77, nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”.

Lidhur mbi kërkesën e certifikatës OEKO-Tex Njësia e Prokurimit gjykon se është e nevojshme me qëllim garancinë e AK për tekstilet se nuk përmbajnë substanca të dëmshme në përbërjen e tyre, me qëllim ruajtjen e shëndetit të punonjësve të institucionit të cilët do të përdorin këto të fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbi kërkesën e autorizimit të prodhuesit është mbi

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në

përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat

ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

II. ARGUMENTIM

MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE TË

1. Pantallona pune

- Materiali/Pelhura e Shtreses se Jashtme/Kryesore: Pesha 210g, 65% Poliester, 35% Pambuk.
- Pelhura duhet kete kaluar processing a anti-tkurres dhe te mbaje shume mire ngjyren.
- Pelhura duhet te jete e perbere me fije pambuku te gjata te qendrueshme ne forme rrethore, per te mos krijuar pushavitje.
- Pantallonat duhet te kete 6 xhepa per hapsire mbajtese me te madhe, 2 xhepa te medhenj anesore te kembet, dy xhepa mbrapa, dy xhepa perpara
- Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV.
- Xhepat ansore te kene hapje mbyllje me grifshe.
- Te gjitha pikat e dobeta te qepjeve te jene te perforcuara.
- Ne pjesen e perparme mberthimi te behet me zinxhire
- Siper te kete mberthim dhe me kopse. Brezi I pantallonit ka te fiksuar yliqe (hallka) per vendosjen e rripit.
- Kopsat te jene ngjyre si tekstili ose te erreta.
- Ngjyra blu e erret.



2. Çizme llastiku

Çizmet do të perdoren nga punonjësit gjatë kryerjes së operacioneve të punës në prani të lagështisë dhe terrenit të rënduar.

Karakteristikat teknike të çizmeve:

- Çizmet të jenë 35 – 37 cm të gjata.
- Të jenë të prodhuar me **Fleksible PVC** e pa ricikluar.
- Sipërfaqja e jashtme të jetë me një shtresë llustere anti-vaj dhe anti-ujë dhe që mundeson që papastërtitë dhe balta të mos ngjitet lehtë.
- Me shtresë tekstili në sipërfaqen e brendshme.
- Pra materiali PVC të jetë pa:
 - Perberes organostannic dhe metalet e rënda
 - Perberes azo dhe / ose bisfenol-A
 - Phthalates
 - Paraffins chlorinated.
 - Agjentët e çlirimit.
- Të rezistojnë ndryshimit të temperaturës së ambientit të punës.
- Të jenë të përshtatshme për të punuar në ambiente me prani të vajrave lubrifikante, karburanteve etj.
- Shuall Anti-Rreshkitje
- Niveli I mbrojtjes OB
- Gjatesia: 40cm
- Ngjyra e çizmeve të jetë e **erret** (jeshile), ndërsa shualli e zeze.



3. Kepuce pune për meshkuj

Kepucet e punes me qafa prodhohen me boks vici, rezituese nga lageshtia, me ngjyre te zeze me qepje rezistente gri.

- Niveli Mbrojtes S3 perfshin:
- Mbuuroja ne majeni e kepuces mundeson mbrojtje te gishtave ndaj Goditjeve deri 200 Xhaul ose 15kN fuqi shtypje.
- Taban brenda Shuallit per Rezistence Anti-rreshkitje
- Mbeshtetje anesore,
- Antistatike,
- Rezistente ndaj vajrave,
- Sistem amortizimi.
- Uje rezituese
- Sholle me dhembeza.

Lenda e pare:

- Materiali I supripes te jete boks vici cilesi e pare, jo poroz,e papershkueshme nga uji, me trashesi jo me te vogel se 1.6 mm.
- Sholle gome kompakte e presuar me element disenjo per mosrreshqitje. Goma kundravajrave,produkte te naftes,etj.
- Lartesia e qafes jo me e vogel se 10 cm.
- Astari I brendshem I faqeve per izolim nga nxehtesia, te jete lekure natyrale ose meshin me trashesi jo me te vogel se 0.5 mm.
- Tabani I kepuces te jete lekure natyrale.
- Fundi (sholla) te jete PU
- Sholla e gomes te jete kompakte e dhembezuar. Te ngjitet me tabanin, fjapen me faqet me ngjites me dy komponente.
- Treguesit Fiziko-Kimike (mbas provave ne laborator)
- Regjia e lekures te jete shume e mire.
- Ngjyrosja jo me pak se nota 8-10.
- Plasaritja jo me pak se 1,55 kg/m
- Qendrueshmeria e faqes gjate terheqjes jo me pak se 2 kg/mm².
- Te jene rezituese ndaj temperatures dhe lageshtires jo me pak se 240 minuta.
- Qendrushmeria e sholles jo me pak se 75 grade C.
- Rezistenca ne shqitje e gomes jo me pak se 30 N (njuton).
- Fortesia e fitilit jo me pak se 1000 g.



4.Mushama shiu

- Materiali 100% Poliester, e Veshur me PVC 210g.
- Me minge te gjata dhe me kapuç. Te jete rezistente nga uji dhe e papërshkueshme prej tij.
- Te stampohet ne anen e majte stema “Ujësjellës Kanalizime Tiranë UKT sh.a.”
- Pelhure e lehte ujeduruese me qepje te izoluara per te ndaluar penetrimin e ujit
- 2 xhepa te medhenj
- Hapje me Zinxhire Para
- Kapuc qe paloset nen jake
- Menge elastike nga Brenda
- Vrima dhe hapje mbrapa per ventilim dhe komfort
- Siperfaqe e pelhures te jete uje resistueses



5. Jelek Fosforeshent me xhepa

- Materiali te jete 50% polyester dhe 50% pambuk me shenja te dukshme dalluese te shiritt fosforishent.

- Te stampohet ne anen e majte stema “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë UKT sh.a.” dhe gjithashtu ne gjithë pjesën e pasme të jelekut .
- Ngjyra portokalli
- Masa : 220gr/m²
- Thurje:2/1 HV (shikueshmeri e larte)Portokalli
- Ngjyre Portokalli HV me 2 shirita fosforishent ne trup.

6. Xhupa me logo UKT

- Të jetë e përbërë nga tre shtresa
- Materiali i jashtëm të jetë ujëdurues (ëaterproof), me qëndrueshmëri të lartë të lartë ndaj erës.
- Materiali i mesit të jetë termoizolues (për një temperaturë me të ulët se -5°C).
- Ngjyra e përdorur duhet të jetë blu e errët.

Përshkrimi i Modelit

- Mbrojtje kundër shiut - Materiali 100% Poliester, me shtrese PVC 230g Cope e vijeziuar.
- Pjesa e sipërme: Fleece 100% Poliester, 280g.
- Pjesa e poshteme & Menget: 100% Poliester, 60g
- Cope e mbushur: Pjesa e poshteme: Mbushje 100% Poliester, 200g
- Menget: Mbushje 100% Poliester, 100g



- Astar i Qepur per Izolim Termal
- Me Shtrese Fleece per ngrohtesi
- 4 xhepa te jashtem, Xhep telefoni , Xhep i brendshem ne kraharor.
- Hapje qendrore para me kopsa dhe zinxhir i dyanshem per hapje te shpejte

- Bel elastik me lidhese me
- Kapuc qe paloset nen jake
- Menge te rregullueshme me grifsh.
- Ngjyra e përdorur duhet të jetë blu e errët.
- Të stampohet në anën e majtë stema “UKT”

7. Bluze me Menge te shkurtra me logo UKT sh.a

Materiali 65% Poliester, 35% pambuk, 210g. Te kete jake, hapje para dhe mbërthimi me tre kopsa. Bluzat te jene me minge te shkurtra Ngjyra blu e erret.



Te stampohet ne anen e majte stema “ Ujësjiellës Kanalizime Tiranë UKT sh.a.”

8. Bluzat me minge te gjata

65% Poliester, 35% Pambuk 210g

Bluzat me minge te gjata praktike dhe e rehatshme Te kete jake, hapje perpara me tre kopsa.

Qepje te dyfishte per me Shume Rezistence. Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV



9.Doreza pune të thjeshta

- EN 420/ EN 388 ose ekuivalente
- 100% poliester
- Ideale dhe resistente per riparime, punime dhe shume sektore te tjera.

10.Kominoshe Pune Kundra ujit, EN-ISO 20471 ose ekuivalente të cilat do të sigurojnë mbrojtje të lartë nga era dhe shiu duke siguruar mbrojtje të plotë dhe dukshmëri të lartë gjatë punës kundër elementëve të ashpër të natyrës.

NJËSIA E PROKURIMIT: